



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazetazyrta e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK), në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 21.07.2021 morri

Vendim

Procedura për kontrollimin e të dhënave mbi statusin e pronës nga pyetësi i -----
-----, Ministri pa portofol -----, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm nga KSHPK-ja sipas lëndës me numër 08-4165/1 të datës 04.09.2019.

Lënda me numër 08-4165/1t datës 04.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4165 / 1 të datës 04.09.2019 është formuar në bazë të Planit Vjetor për monitorimin e situatës së pronës dhe interesave për vitin 2019.

KSHPK, nga i emruari kërkoi të dhëna për anëtarët e familjes së tij me të cilët ai jeton në një shtëpi të përbashkët.

Të dhënat e kërkuara janë dorëzuar nga i emruari.

KSHPK, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, mori të dhëna për pasurinë e ----- dhe anëtarëve të familjes së tij nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e të Hyrave Publike, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK, pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet e përmendura, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr Borce Stojanovski, bashkëpunëtor i lartë
Miratoi: Katica Nikollovska

KOMISIONI SHTETROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

